

DËRGO APOSTUJ TË SHENJTË
HIMNI I VITIT THIROR KOMBËTAR 2021-2022
TEKSTI DHE MUSIKE: Familja e Vogël - Uznova

Ref.: Re La/Re Sol Re
Dërgo punëtorë në të korrat e tua
Sol Re Sol La
dërgo , o Zot, apostuj të shenjtë!
Re La Sol Re
Dërgo, o Zot, apostuj të shenjtë
Sol Re Sol Re
e, ashtu si do, edhe mua më dërgo.

Re La Sol Re
Ja ku jam o Zot, zërin tënd dëgjova,
Sol Re Sol La
nga Zemra jote mora guxim
Re La Sol Re
Shpirti i Shenjtë, Shpirti i profecisë
Sol Re Sol Re
eja në ne dhe apostuj na bej.

Fa# Si- Sol Re
Krishti Jezus u ngjiti në një mal
Sol Re Do La
dhe iu lut Atit gjithë atë natë.
Fa# Si- Do Sol
Syte e tij i ngriti te Ai
Sol Do Sol La7
Ata që deshi i mori prej Tij:

Në fund të natës me zë të lartë,
i thirri tek vetja të gjithë ata,
ata që deshi: Pjetri i parë
i vëllai Andrea, të dymbëdhjetë:

Pasi i dërgoi apostujt e tij
u tha Jezusi: «vëzhgoni lart:
ja, këto të korrat: sa të mëdha!
Të Zotin lutuni, lutuni pra»

«Shihni të korrat e Atit tim:
të rinjtë që enden, enden pa shpresë
të rinjtë që presin të gjejnë një Atë,
një nënë që lajmin e mirë t'i tregojë »

«Shihni të varfërit: popull pa masë
që ditë e natë po kërkon drejt'si
turma pa zë, pa të drejta, pa shpresë
presin të njohin lajmin e mirë».

«Shihni familjet, shtëpitë e Shqipërisë:
vatra të vrarë nga jeta e vështirë
e presin Fjalën e lajmit të mirë
që sheron zemrat dhe mbush me gëzim».

«Shihni të korrat e popullit tim:
malet e fushat, Jug e Veri,
njerëz që presin rrugën për kthim,
për kthim tek Ati plot me mëshirë».

Aty ku mbolli një popull martir
janë pjekur frytet që mbesin në amshim.
Shkoni, punoni: mblidhni të mijtë,
gati është Qielli, grunarët e mi.